



Проектот е  
финансиран од  
Европската Унија

Проект: Вработување на лица  
со попреченост - одржлив модел  
Operational Programme 'Human Resources  
Development 2007-2013'



# PUNËDHËNËS **PA** BARRIERA

**SERVIS PËR MBËSHETJE  
PËR PËRFSHIRJEN NË  
PUNË TË PERSONAVE ME  
AFTËSI TË KUFIZUARA**

Проектот е имплементиран од

**KONEKT**



**Отворете  
ги прозорците**





## DOBIA PËR BIZNESIN

Pse duhet të punësoni person me aftësi të kufizuar?

### ZGJEDHJE MË E GJERË PËR REKRUTIMIN E KUADROVE

15% e popullatës botërore ka ndonjë aftësi të kufizuar. Ata mund të jenë punëtorë tuaj produktiv dhe/apo klientë/e lojal/e.

### QASJE NË BENEFICIONE

Për punësimin e personave me aftësi të kufizuara pason mbështetje financiare nga shteti.

### TË PUNËSUAR TË VLEFSHËM

Punëdhënësit të cilët kanë punësuar persona me aftësi të kufizuara theksojnë se janë punëtorë lojal, e kryejnë mirë punën dhe kanë shkallë të ulët të mungesës. Fuqia punëtore e ndryshme dhe mundësitë e barabarta ndikojnë mirë për të gjithë në produktivitetin dhe ndërtimin e një ekipi që i pranon diversitetet. Bëhuni shembull i mirë si punëdhënës i mirë.



## **NDRYSHIME TË MIRA DHE RRRITJE TË BIZNESIT**

Përshtatjet e bëra për të punësuarit me aftësi të kufizuara janë të dobishme edhe për të punësuarit e tjerë si dhe për klientët. Krijoni produkte dhe shërbime të reja ose adaptoni ekzistueset për konsumatorët me aftësi të kufizuara. Të punësuarit me aftësi të kufizuara mund të kyçen në këtë proces.

## **PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE**

Diversiteti në kuadër është përparësi e fuqishme e bizneseve të përgjegjshme. Tek ne punësimi i personave me aftësi të kufizuara në bizneset klasike është dukuri e rallë. Bëhuni shembull i mirë dhe nxitni ndryshime.







## ÇFARË OFRON SERVI SI?

### SHËRBIME TË THURURA SIPAS MASËS SONË

Shikojeni zgjedhjen tonë të shërbimeve dhe shënoni se çfarë është e dobishme për biznesin tuaj që të punësojë persona me aftësi të kufizuara. Identifikoni edhe nevojat plotësuese. Shërbimet funksionojnë ndaras dhe në pako. Na kontaktoni për takim dhe ne do ta përkufizojmë ofertën për ju.

### NE JEMI PARTNERËT TUAJ PROFESIONAL

Ekipi ynë është fleksibil dhe me ekspertizë specifike.

KONEKT është organizatë eksperte për ndryshimin e përgjegjësisë shoqërore si pjesë e zhvillimit të biznesit.

HAPNI DRITARET janë të vetmit në rajon tërësisht të përkushtuar për promovimin dhe përdorimin e teknologjisë ndihmëse që siguron inkluzionin ose përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në punë.







# KONTROLL

## BARRIERAT NË TEST

- Kontrollil i qasjes së kompanisë

Duke i pasur parasysh pengesat e ndryshme do të identifikohen barrierat e komunikimit, fizike dhe sociale. Mund ta kontrollojmë qasjen në aspekt të 1) punëdhënësit 2) shërbimeve dhe prodhimeve që i ofroni.

- Kontrolli i politikave dhe praktikave në fushën e rekrutimit dhe menaxhimit me resurset njerëzore në aspekt të sigurimit të mbrojtjes nga diskriminimi, si dhe mundësi të barabarta

dhe inkluzion të aftësive të kufizuara. Vlerësohet përputhshmëria me rregullat ndërkombëtare dhe vendore, praktikatat e mira dhe rekomandimet në domenin e përgjegjësisë shoqërore, biznesit dhe të drejtave të njeriut (të punëtorëve) etj.

- Pas kontrollit definojnë: rekomandimet, planet dhe masat për tejkalimin e barrierave të identifikuar. Servisi ofron shërbime dhe mbështetje për zbatimin e tyre.






## POLITIKAT DHE PROCEDURAT


### MBËSHTETJE PROFESIONALE NË ADAPTIMIN OSE KRIJIMIN E:

- Politikave për mundësi të barabarta për punësim dhe mbrojtje nga diskriminimi ;
- Politikave dhe procedurave në fushën e resurseve njerëzore në

aspekt të inkluzionit të personave me aftësi të kufizuara;

- Protokolleve dhe rregulloreve për komunikim me personat me aftësi të kufizuara të ndryshme;
- Rregullave për shëndet dhe siguri në punë në aspektin e atësisë së kufizuar.





## TRAJNIME

Krijojmë dhe zbatojmë trajnime për menaxhmentin dhe personelin tuaj:

- Biznesi dhe të drejtat e njeriut/ Përgjegjësia shoqërore dhe diversiteti në fuqinë punëtore; / Statusi i punëdhënësit pa barriera

- Komunikim me persona me aftësi të kufizuara të ndryshme / tejkalimi i barrierave;
- Punësimi i personave me aftësi të kufizuara/ përshtatje të arsyeshme dhe përdorimi i teknologjisë ndihmëse;
- Qasja e prodhimeve dhe shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara;
- Tema të tjera sipas nevojës.

Trajnimet do të ndihmojnë në krijimin e mjedisit inkluziv të punës dhe në largimin e barrierave sociale.





## РЕГРУТАЦИЈА И ПОВРЗУВАЊЕ

Profesionistët e fushës së resurseve njerëzore mund të mbështeten tek ne për:

- Analizimin e pozitave të punës dhe identifikimin e vendeve të punës të përshtatshme për punësimin e personave me aftësi të kufizuara;
- Mbështetjen në definimin e shpalljeve dhe shpërndarjen e tyre me qëllim që të arrijnë deri te kandidatët/et potencialë/e me aftësi të kufizuara;
- Sigurimin e mundësive të barabarta gjatë testimit dhe

intervistës së kandidatëve me aftësi të kufizuara (kontrolli i pyetjeve dhe indikatorë, këshilla dhe/ose zbatimi i testiti dhe intervistës);

- Lidhje me kandidatët/tet me aftësi të kufizuara në bazë të nevojave të punëdhënësit dhe mundësive dhe kualifikimeve të personit. Kemi bazë të të dhënave të mbi 100 personave të papunësuar me aftësi të kufizuara.







## ADAPTIM I ARSYESHËM

- Definimi dhe zbatimi i planit për adaptim të arsyeshëm për të punësuarit me aftësi të kufizuara (planifikimi i adaptimeve fizike dhe teknologjike, definimi i orarit fleksibil të punës, etj) ;
- Vlerësimi i nevojës për teknologji ndihmëse\* dhe furnizimi i saj;
- Testimi i përshtatjeve të bëra përmes simulimit të punës dhe në konsultime me personin me aftësi të kufizuar;
- Këshillim për çështje të ndryshme në lidhje me aftësitë e kufizuara

\* Teknologjia ndihmëse u mundëson personave me aftësi të kufizuara t'i kryejnë obligimet në punë me shpejtësi dhe kualitet të njëjtë si personat që s'kanë aftësi të kufizuara. P.sh. personi me shikim të dëmtuar mund të përdorë tastierë me taste të mëdha, lexues së ekranit etj.





## NË VENDIN E PUNËS

- Mbështetje në zbatimin e punës provë për personat me aftësi të kufizuara;
- Mbështetje për adaptim dhe inkluzion në vendin e punës të personave me aftësi të kufizuara (mbështetje mentorike, përgatitja e mjedisit të punës, masa për kulturë gjithëpërfshirëse të punës etj.)
- Krijimin, definimin dhe zbatimin e planit për mbështetje të personave me aftësi të kufizuara;
- Këshilla të tjera, mentorim dhe trajnime në pajtueshmëri me nevojat e punëdhënësve.



Drejtohuni tëk ne për doracakun tonë praktik falas për punësimin dhe menaxhimin e personave aftësi të kufizuara. Caktoni takim që të përgatisim ofertë të veçantë sipas nevojave tuaja:

## Konekt

rr. „Vlladimir Pollezhinovski”  
19-1/6,  
1000 Shkup  
Tel: +389(2) 3224 198  
e-mail: [konekt@konekt.org.mk](mailto:konekt@konekt.org.mk)

[www.konekt.org.mk](http://www.konekt.org.mk)

## Hapni dritaret

bul. „Aradhet Partizane”  
nr. 62/2-29,  
1000 Shkup  
Tel: +389(2) 30 68 630  
e-mail: [contact@openthewindows.org](mailto:contact@openthewindows.org)

[www.openthewindows.org](http://www.openthewindows.org)